



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1987/3 prot

Datë, 25.10.2021

V E N D I M
K.P.P. 805/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.10.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.*REF-07567-10-82021* me objekt: “*Blerje kancelari dhe tonera*”, me fond limit 1.999.070 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë

Ankimues:

“Infosoft Office” SHPK
Autostrada Tiranë – Durrës, Km.8, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 24 e vijues
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe*

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.10.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-07567-10-82021 me objekt: “Blerje kancelari dhe tonera”, me fond limit 1.999.070 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

II.2. Në datën 18.10.2021 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën

dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.1511/1 prot., datë 20.10.2021, protokolluar me tonën me nr.1987/2 prot., datë 21.10.2021 me objekt “*Kthim përgjigje mbi ankesën e depozituar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Referuar shkresës së mësipërme të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“Në lidhje me pikën ku ju jeni shprehur se: “1.Në shtojcën 5 (Formulari i specifikimeve teknike) AK ka publikuar logon e institucionit, si edhe ka kërkuar që disa nga artikujt e listës të jenë të loguar, por nuk është sqaruar pozicionimi i logos mbi artikujt e loguar për cdo rast. Lutemi të na jepen këto informacione”, ju sqarojmë se mostra kërkohet për të përcaktuar nëse produkti i kërkuar plotëson kërkesat sipas specifikimeve teknike (produkti dhe cilësia e printimit) dhe pozicionin e logos gjeni sqarimet përkatëse për secilin nga artikujt që kërkohet personalizim.

- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrat 1, 3, 4 do ketë respektivisht logo me dimensione të përafërta: 55 x 30 mm dhe duhet të jetë e pozicionuar në mesin horizontal dhe e barazlanguar 4 cm nga konturi i sipërm me konturin kufizues të logos, në drejtimin vertikal. Si mëposhtë mund të gjeni dhe skicimin grafik, fig 1.*
- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrat 5, 17 do ketë respektivisht logo me dimensione të përafërta: 55 x 30 mm dhe duhet të jetë e pozicionuar në mesin horizontal dhe vertikal. Si mëposhtë mund të gjeni dhe skicimin grafik, fig 2.*
- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrin 9 do ketë respektivisht logo me dimensione në raport 1/3 me dimensionet e sipërfaqes së printueshme.*

Përsa i përket pikës ku ju keni cituar se “2. Në shtojcën 5 (Formulari i specifikimeve teknike) AK ka kërkuar zarfa të loguar me logon dhe adresën, si do jetë ajo e pozicionuar në logim (pra mbi logon, nën logon, anash saj, etj) dhe si do të pozicionohen logo bashkë me adresën në zarf (në mes të zarfit, në ndonjë prej këndeve etj). Të gjitha këto janë informacione të cilat nevojiten për përgatitjen e ofertës.” Ju bëjmë me dije se së pari jemi bazuar në rregullin universal, të përcaktimit të zonave për vendosjen e Dërguesit dhe Marrësit. Gjithësesi për tua qartësuar ju sqarojmë se:

- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrat 10, 11, 12 do ketë respektivisht logo me dimensione minimale: 30 x 16 mm dhe duhet të jetë e barazlanguar 2 cm, nga konturi lart dhe majtas. Ndërsa teksti, do përmbajë adresën të cilën vetë ju si operator ekonomik e keni shënuar mbi zarfin e ankesës që keni depozituar pranë autoritetit kontraktor “Rruga Abdi Toptani, 1001, Tiranë – Shqipëri, Tel. +35542274774, konsumatori@tirana.al, ëëë.mbrojtjakonsumatorit.al” dhe duhet të jetë minimalisht e madhësi 7 pt dhe me largësinë nga rreshti 9 pt. Skicimin grafik për rastin zarf DL, do të mund ta aplikoni edhe për zarfin A5 dhe atë A4. Dhe së dyti në lidhje me pikën në të cilën citohet që “pozicionimi i logos me adresë apo pa adresë, i pozicionuar lart apo poshtë ju nevojitet për përgatitjen e*

ofertës”, ju informojmë se asnjë nga këto të dhëna që ju kërkon nuk është komponent që ndikon në kosto kur personalizohen mostrat.

Ndërsa për sa i përket pikës 5 ku ju keni cituar se: “Për disa nga artikujt na nevojiten sqarimet si më poshtë:

Artikulli 19 – Letër A4 format kartoni me ngjyra 500 fije x 1 pako

Sa gramë duhet të jetë karton? Ka karton 160gr, 200 gr, 210 gr, 270 gr etj..

Artikulli 30 – Stilolapsa të thjeshtë k – 15 me majë 1 mm top 505 ose Fave

Nuk mund të kërkon një markë apo model të caktuar, por përcaktoni specifikimet e produktit. Sic e dikton edhe LPP, kudo që përmendet markë, duhet të shoqërohet me fjalën “ose ekuivalent”. Fjalët “k-15” apo “top 505 ose Fave” përcaktojnë vetëm markë apo vetëm një model, gjë që bie në kundërshtim me LPP.

Artikulli 52 – Bojë printeri Xerox Phaser 3330/ëork Center 3335/3345 Black Toner Cartridge, High Capacity ose ekuivalent

Nuk jemi të qartë për kapacitetin që kërkon për këtë artikull. Ju lutem caktoni numrin e kopjeve ose kodin e bojës.

Artikulli 67 – Drum L E460DN / E260A11E ose ekuivalente

Kodi i kërkuar nga ana juaj E260A11E është për toner, ndërkohë që në përshkrim keni thënë “DRUM”. Ju lutemi na sqaroni nëse kërkon DRUM apo toner.”, ju lutem të gjeni si më poshtë sqarimet përkatëse:

Artikulli 19: Peshë e letrës duhet të jetë 160 gr./m² dhe kutia duhet të përmbajë 250 fletë.

Artikulli 30: Emërtimi i artikullit do të ndryshohet në “Stilolapsa të thjeshtë me majë 1 mm”

Artikulli 52: Numri i kopjeve, që toneri duhet të printojë duhet të jetë 15k.

Artikulli 67: Kërkohet Drum për printerin L-E460DN ose ekuivalent.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr.1511/1 prot., datë 20.10.2021, protokolluar me tonën me nr.1987/2 prot., datë 21.10.2021 me objekt “*Kthim përgjigje mbi ankesën e depozituar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK*”, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“Në lidhje me pikën ku ju jeni shprehur se: “1.Në shtojcën 5 (Formulari i specifikimeve teknike) AK ka publikuar logon e institucionit, si edhe ka kërkuar që disa nga artikujt e listës të jenë të loguar, por nuk është sqaruar pozicionimi i logos mbi artikujt e loguar për cdo rast. Lutemi të na

jepen këto informacione”, ju sqarojmë se mostra kërkohet për të përcaktuar nëse produkti i kërkuar plotëson kërkesat sipas specifikimeve teknike (produkti dhe cilësia e printimit) dhe pozicionin e logos gjeni sqarimet përkatëse për secilin nga artikujt që kërkohet personalizim.

- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrat 1, 3, 4 do ketë respektivisht logo me dimensione të përafërta: 55 x 30 mm dhe duhet të jetë e pozicionuar në mesin horizontal dhe e barazlanguar 4 cm nga konturi i sipërm me konturin kufizues të logos, në drejtimin vertikal. Si mëposhtë mund të gjeni dhe skicimin grafik, fig 1.*
- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrat 5, 17 do ketë respektivisht logo me dimensione të përafërta: 55 x 30 mm dhe duhet të jetë e pozicionuar në mesin horizontal dhe vertikal. Si mëposhtë mund të gjeni dhe skicimin grafik, fig 2.*
- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrin 9 do ketë respektivisht logo me dimensione në raport 1/3 me dimensionet e sipërfaqes së printueshme.*

Përsa i përket pikës ku ju keni cituar se “2. Në shtojcën 5 (Formulari i specifikimeve teknike) AK ka kërkuar zarfa të loguar me logon dhe adresën, si do jetë ajo e pozicionuar në logim (pra mbi logon, nën logon, anash saj, etj) dhe si do të pozicionohen logo bashkë me adresën në zarf (në mes të zarfit, në ndonjë prej këndeve etj). Të gjitha këto janë informacione të cilat nevojiten për përgatitjen e ofertës.” Ju bëjmë me dije se së pari jemi bazuar në rregullin universal, të përcaktimit të zonave për vendosjen e Dërguesit dhe Marrësit. Gjithësesi për tua qartësuar ju sqarojmë se:

- *Mostrat për artikujt sipas listës me numrat 10, 11, 12 do ketë respektivisht logo me dimensione minimale: 30 x 16 mm dhe duhet të jetë e barazlanguar 2 cm, nga konturi lart dhe majtas. Ndërsa teksti, do përmbajë adresën të cilën vetë ju si operator ekonomik e keni shënuar mbi zarfin e ankesës që keni depozituar pranë autoritetit kontraktor “Rruga Abdi Toptani, 1001, Tiranë – Shqipëri, Tel. +35542274774, konsumatori@tirana.al, ëëë.mbrotjakonsumatorit.al” dhe duhet të jetë minimalisht e madhësi 7 pt dhe me largësinë nga rreshti 9 pt. Skicimin grafik për rastin zarf DL, do të mund ta aplikoni edhe për zarfin A5 dhe atë A4. Dhe së dyti në lidhje me pikën në të cilën citohet që “pozicionimi i logos me adresë apo pa adresë, i pozicionuar lart apo poshtë ju nevojitet për përgatitjen e ofertës”, ju informojmë se asnjë nga këto të dhëna që ju kërkoni nuk është komponent që ndikon në kosto kur personalizohen mostrat.*

Ndërsa për sa i përket pikës 5 ku ju keni cituar se: “Për disa nga artikujt na nevojiten sqarimet si më poshtë:

Artikulli 19 – Letër A4 format kartoni me ngjyra 500 fije x 1 pako

Sa gramë duhet të jetë karton? Ka karton 160gr, 200 gr, 210 gr, 270 gr etj..

Artikulli 30 – Stilolapsa të thjeshtë k – 15 me majë 1 mm top 505 ose Fave

Nuk mund të kërkoni një markë apo model të caktuar, por përcaktoni specifikimet e produktit. Sic e dikton edhe LPP, kudo që përmendet markë, duhet të shoqërohet me fjalën “ose ekuivalent”. Fjalët “k-15” apo “top 505 ose Fave” përcaktojnë vetëm markë apo vetëm një model, gjë që bie në kundërshtim me LPP.

Artikulli 52 – Bojë printeri Xerox Phaser 3330/ëork Center 3335/3345 Black Toner Cartridge, High Capacity ose ekuivalent

Nuk jemi të qartë për kapacitetin që kërkoni për këtë artikull. Ju lutem caktoni numrin e kopjeve ose kodin e bojës.

Artikulli 67 – Drum L E460DN / E260A11E ose ekuivalente

Kodi i kërkuar nga ana juaj E260A11E është për toner, ndërkohë që në përshkrim keni thënë “DRUM”. Ju lutemi na sqaroni nëse kërkon DRUM apo toner.”, ju lutem të gjeni si më poshtë sqarimet përkatëse:

Artikulli 19: Pesha e letrës duhet të jetë 160 gr./m² dhe kutia duhet të përmbajë 250 fletë.

Artikulli 30: Emërtimi i artikullit do të ndryshohet në “Stilolapsa të thjeshtë me majë 1 mm”

Artikulli 52: Numri i kopjeve, që toneri duhet të printojë duhet të jetë 15k.

Artikulli 67: Kërkohet Drum për printerin L-E460DN ose ekuivalent.”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.*REF-07567-10-82021* me objekt: “*Blerje kancelari dhe tonera*”, me fond limit 1.999.070 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.
 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri